



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:217242
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659560

Pml.nr.287/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh. L., për shkak të veprës penale krim i luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP-RSFJ), si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit, av. Jovana Filipoviq, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PPPS.nr.50/2023 të datës 11.3.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës, PN.I.S.nr.55/2024 të datës 20.3.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 7.5.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit Sh. L., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PPPS.nr.50/2023 të datës 11.3.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës, PN.I.S.nr.55/2024 të datës 20.3.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.50/2023 të datës 11.3.2024, të pandehurit Sh. L., për shkak të veprës penale krim i luftës kundër popullsisë

civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP-RSFJ, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t'i zgjasë nga data 11.3.2024 deri më datën 10.5.2024. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.I.S.nr.55/2024 të datës 20.3.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit Sh. L. av. Jovana Filipoviq, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'i ndërprehet masa e paraburgimit ose ndaj tij të caktohet ndonjëra nga masat alternative më të buta të parapara me nenin 171 të KPP.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.123/2024 të datës 7.5.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësja e të pandehurit thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë marrë dhe bazohen në supozime abstrakte pa bazë ligjore. Mbrojtja konsideron se janë shkelur neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) - e drejta në liri dhe siguri, neni 6 i KEDNJ - e drejta në gjykim të drejtë, neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës - e drejta në liri dhe siguri, neni 30 i Kushtetutës - të drejtat e të akuzuarit, neni 31 i Kushtetutës - e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 2 i KPP - shqiptimi i sanksionit penal nga gjykata kompetente e pavarur dhe e paanshme, neni 128 par. 2 i KPP - marrja në pyetje në procedurën paraprake, neni 129 par. 6 dhe par. 7 i KPP - marrja e deklaratës në procedurë paraprake, neni 159 par. 2 i KPP - parimi i interpretimit, neni 171 i KPP - masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, neni 182 i KPP - paraburgimi dhe neni 184 i KPP - kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit. I pandehuri është i privuar nga liria me datën 14.10.2023 dhe kanë kaluar përafërsisht gjashtë muaj dhe i pandehuri nuk është dëgjuar nga ana e prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës me çka i është shkelur e drejta në mbrojtje. Mbrojtjes nuk i janë dhënë të gjitha shkresat e lëndës dhe se nuk është ftuar asnjë herë gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetimore. I pandehuri tërë jetën e tij ka jetuar në territorin e Kosovës, ka dokumentacion të rregullt, rregullisht ka vizituar Prizrenin dhe Dragashin, qytetin e tij të lindjes, dhe askush nuk ka raportuar ndonjëherë se ka kryer një vepër penale për të cilën akuzohet dhe është e qartë se asnjë vëzhgues objektiv nuk mund të bindet se ai do të ketë kryer krime lufte

kundër popullsisë civile, sipas logjikës së gjërave, po të kishte kryer diçka të tillë nuk do të jetonte më në Kosovë duke pritur në çdo moment arrestimin. I pandehuri nuk është fshehur, kurrë nuk ka qenë në arrati sepse ndaj tij kurrë nuk ka pasur procedurë të iniciuar, ka identitet të njohur dhe nuk ka rrethana që tregojnë rrezikun e arratisjes. Gjykata e instancave më të ulëta gabimisht dhe padrejtësisht dhe në mënyrë jokushtetuse kanë gjetur si rrethanë rënduese rrethanën se i pandehuri ka edhe shtetësi të Republikës së Serbisë dhe si rrethanë për caktimin e masë së paraburgimit. Mbrojtja vë në dukje se të gjithë personat të cilët para vitit 1999 kanë jetuar në territorin e Kosovës kanë shtetësi të Serbisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal nga Policia e Kosovës – DHKL në Prishtinë, me numër Reference 08/3-75/2023 i datës 6.8.2023, Raporti përmbledhës – informues hetimor – Sektori i hetimeve të krimeve të luftës dhe personave të zhdukur me numër rasti R-2023-XI-HK-HKR-SKL-30 të datës 23.6.2023, dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në Stacionin Policor në Rahovec, njësia DHKL, dëshmia e dëshmitarit të dhënë me datë 23.6.2023 dhe 3.7.2023 si dhe me datë 18.7.2023, procesverbali mbi identifikimin e personit, me numër rasti R-2023-XI-HK-HKR-SKL-30, dëshmia e dëshmitarit të dhënë me datën 31.7.2023 në Stacionin Policor Rahovec, me numër Rasti R-2023-XI-HI-HKHKR-SKL-30, dëshmia e dëshmitarit të dhënë me datën 18.7.2023 në Stacionin Policor Rahovec, me numër rasti R-2023-XI-HK-HKR-SKL-30, dëshmia e dëshmitarit të dhënë me datën 18.7.2023 në Stacionin Policor Rahovec, me numër rasti R-2023-XI-HK-HKR-SKL-30, procesverbali mbi identifikimin e personit, sistemi për menaxhimin e kufirit SMK i datës 5.7.2023 në kërkim të personave, raport për të pandehurin Sh. L. dhe raporti informues i datës 14.10.2023 me numër të referencës 08/031 I 08/2023 lidhur me ndalimin e të pandehurit në pikën kufitare Merdare, raporti i shpejtë me numër rasti 2023-XIHKL-05 i datës 14.10.2023 Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën pandehet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2. të KPP.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1. të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se i pandehuri ka vendbanim të përhershëm në Serbi, shtetësi edhe të Serbisë, se është identifikuar nga dëshmitarët për veprën penale krime të luftës kundër popullatës civile, me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja në liri apo nën ndonjë masë më të butë alternative, sipas propozimit të mbrojtëses së të pandehurit nuk qëndrojnë dhe janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.287/2024, me datë 7.5.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj